



BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Specialist)**

Lloji i diplomës “Shkenca Sociale/Psikologji/Filozofi/Shoqërore” niveli minimal i diplomës “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II ,III,IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtorja e Planifikimit të Burimeve Njerëzore, Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në Shërbimin Civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës III-b;
- 1 (një) Specialist në Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, kategoria e pagës III-b;

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **02 Shtator 2016**

Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **07 Shtator 2016**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- a. Përgjigjet për analizimin e situatës së shërbimit social, evidentimi i problematikës, zbatimi dhe menaxhimi i programeve dhe projekteve sociale, në mbështetje të kategorive në nevojë, për të lehtësuar dhe përmirësuar situatën social-ekonomike të komunitetit të qytetit të Tiranës.

- b. Merr pjese ne hartimin e politikave dhe programeve për kujdesin social, mbledh dhe analizon informacionin mbi situatën sociale të shtresave në nevojë dhe kategorive në risk.
- c. Nxitja e barazisë gjinore dhe një pjesëmarrje të gjerë të gruas në jetën ekonomike, politike e kulturore të qytetit si dhe hartimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, e në përgjithësi të dhunës me bazë gjinore.
- d. Sigurimi i mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe nga çdo lloj formë sjelljeje që nxit diskriminimin, si dhe i së drejtës së çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- e. Pergjigjet punën për promovimin e plotë e produktiv, punësim dinjitoz për qytetarët e Tiranës, veçanërisht për të rinjtë dhe grupet që mund të identifikohen, të mbështetura në politikat aktive të punësimit në Bashkinë e Tiranës
- f. Lehtësim të kontakteve ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, afrimi i shkollës dhe universitetit me biznesin;

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë (IV-b/ IV-a / III-b);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional ” në Shkenca Sociale/Psikologji/Filozofi/ Shoqërore

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda **datës 2 Shtator 2016**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **6 Shtator 2016**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.3 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015 për Vetëqëverisjen Vendore;
- b- Ligji nr 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- c- Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";
- d- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Per rregullat e etikës në administratën publike”;
- e- Ligjin nr.9355 date 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar;
- f- Ligjin Nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës"

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë.Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe standat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë dhe standat e informimit të publikut duke filluar nga data **12 Shtator 2016**.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHERBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- b- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional ” në Shkenca Sociale/Psikologji/Filozofi/ Shoqërore”

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Tiranës brenda datës **07 Shtator 2016**.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **12 Shtator 2016**, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Planifikimit të Burimeve Njerëzore Rekrutimit dhe Procedurave në Bashkinë e Tiranës do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Tiranës do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në Shërbim Civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Bashkisë Tiranë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data **12 Shtator 2016**.